

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË RAJONALE TË MJEDISIT QARKU DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Qarku Durrës, me objekt “Mbi veprimtarinë për monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit” për periudhën nga data 01.01.2011 deri më datë 31.10.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 31 datë 31.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 1071/7 datë 31.03.2014, dërguar Z. Lefter Koka, Ministër i Mjedisit dhe shkresën nr. 1071/8 datë 31.03.2014 dërguar zj. Kontiana Kuci, Kryetare e Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Qarku Durrës, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

I. Për Ministrinë e Mjedisit:

1. Të përcjellë vendimet e marra nga ana e saj në Agjencinë Rajonale të Mjedisit, me qëllim informimin e këtyre të fundit për këto vendime, për dhënie apo refuzim të lejeve për subjektet që ARM ka dhënë mendime pozitive e në veçanti ato negative.

Menjëherë

2. Të hartojë e miratojë formatin e regjistrit të lejeve mjedisore në zbatim të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Menjëherë

3. Të përditësojë formatin e pëlqimit dhe autorizimit mjedisor për subjektet të cilat kanë aplikuar në ARM, duke e plotësuar me të dhëna si: përshkrimi i detajuar i veprimtarisë së lejuar, natyra e veprimtarisë dhe hollësitë e çdo shkarkimi të autorizuar nga leja, kërkesat dhe kushtet e ndërtimit dhe të funksionimit të veprimtarisë së lejuar, kërkesat konkrete të raportimit duke përcaktuar normat dhe standardet mjedisore të shkarkimeve, kushtet sipas ligjeve të tjera të veçanta mjedisore sipas natyrës specifike të veprimtarisë.

Vazhdimisht

II. Për Agjencinë Rajonale të Mjedisit:

1. Të specifikojë kushtet që do të vendosen në lejen mjedisore, në mënyrë sa më konkrete sipas natyrës së aktivitetit apo projektit, si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe asaj të shfrytëzimit, në mënyrë që të arrihet një kontroll sa më efikas dhe konkret në zbatimin e kushteve të vendosura në lejen mjedisore si dhe përfitimim e të dhënave të nevojshme për hartimin e regjistrit kombëtar të ndotësve.

Menjëherë

2. Të hartojë regjistrin kadastral mjedisor, dixhital elektronik për qarkun, nëpërmjet shfrytëzimit të të dhënave konkrete të pasqyruara në lejet mjedisore, e cila i shërben Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për marrjen e masave me qëllim që të evitohet ndotja dhe dëmtimi i mjedisit dhe përbërësve të tij si dhe të rritet cilësia e jetës së qytetarëve për këtë qark.

Menjëherë

3. Në autorizimet e dhëna, të përcaktohen në mënyrë konkrete vendi i depozitimit të mbetjeve të gjeneruara, mënyra si do të trajtohen si dhe vendi i depozitimit të mbetjeve të rrezikshme që gjenerohen gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit.

Vazhdimisht

4. Në pëlqimet dhe autorizimet e dhëna, të përcaktohen sipërfaqet e gjelbëruara përreth aktivitetit, lloji i tyre i shprehur në m², si të dhëna të domosdoshme që do të bënin të mundur minimizimin e efekteve negative mbi mjedisin dhe shëndetin e komunitetit ku aplikohen këto veprimtari.

Vazhdimisht

5. Dosjet mjedisore, të përditësohen në mënyrë të plotë nga ana e Njesisë së Inspektimit, në zbatim të Rregullores nr. 3, datë 10.09.2010 “Për krijimin dhe administrimin e dosjes mjedisore si dhe rregullat e hollësishme për formën dhe përmbajtjen e saj”.

Menjëherë

6. Dosjet e mjedisit, të hartohen dhe të ruhen të plota si dhe të përditësohen për çdo subjekt, në mënyrë që kontrollet e kryera nga inspektorët e mjedisit të jenë të diktuar nga problematika e veçantë, të mos kryhen si kontrole rutinë të cilat rrezikojnë të mos nxjerrin në pah problemet e vërteta dhe nuk ndikojnë realisht në ruajtjen apo aty ku është e nevojshme përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Menjëherë

7. Të informojë në mënyrë periodike dhe të detyrojë subjektet që të dorëzojnë rregullisht raportet e vetëmonitorimit në të cilat të pasqyrohen analizat specifike të kryera, sipas të gjitha kushteve të vendosura në lejet përkatëse mjedisore.

Vazhdimisht

8. Në zbatim të nenit 69 “Kundërvajtjet”, pika 1/dh, ligji nr. 10431, datë 09.06.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”, të gjobisë subjektet të cilat kryejnë monitorimin e mjedisit dhe nuk plotësojnë kërkesat për minimizimin e ndërhyrjes mbi përdorimin e tokës, pas kryerjes së veprimtarisë dhe për rikthimin e tokës në gjendjen e saj të mëparshme, sipas përcaktimit në nenin 43 të këtij ligji.

Vazhdimisht

9. Të hartojë raportin vjetor mjedisor për qarkun e Durrësit, mbështetur në të dhënat mbi gjendjen e treguesve të mjedisit të grumbulluara nga subjektet të cilat kryejnë vetëmonitorime të shkarkimeve të veprimtarisë së tyre në mjedis.

Vazhdimisht

Për Njësinë e Inspektimit:

1. Të hartojë objektiva e plane të hollësishme me parametra të përcaktuar, për kryerjen e inspektimeve të vazhdueshme e të përsëritshme mbi gjendjen e të gjithë treguesve mjedisorë si dhe mbi subjektet që ushtrojnë aktivitetet në qarkun e Durrësit.

Vazhdimisht

2. Në zbatim të nenit 69 “Kundërvajtjet”, pika 1/h, ligji nr, 10431, datë 09.06.2011”Për mbrojtjen e mjedisit”, të gjobisë ato subjekte të cilat nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në njoftimin e pezullimit, brenda afatit sipas përcaktimit në nenin 66 të këtij ligji.

Vazhdimisht

3. Në akt kontrollet apo akt verifikimet e mbajtura gjatë inspektimeve të kryera, të lërë detyra specifike bazuar në aktivitetin e problematikën e subjektit si dhe të mbështetura në kushtet e lejes mjedisore dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Vazhdimisht

4. Të hartojë regjistrin fizik e dixhital të të dhënave për të gjitha subjektet e kontrolluara, të shoqëruara me detyrat përkatëse si dhe regjistrin ku të jenë të evidentuara subjektet me ndikim të lartë e të mesëm në mjedis.

Menjëherë

5. Të hartojë programe të përbashkëta bashkëpunimi dhe kontrolli me të gjithë subjektet që ligji i ngarkon në mbrojtje të mjedisit, si dhe të kërkojë me rigorozitet zbatimin e tyre.

Vazhdimisht

6. Në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit të analizohen rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes administrative, të bëhet klasifikimi i shkeljeve sipas referencave ligjore si dhe verifikimeve në subjektet e gjobitura për arkëtimin e gjobave të vëna.

Vazhdimisht

B. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenin 37, të ligjit 7961 datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe në kontratën kolektive të punës Ministrisë së Mjedisit të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”

Për:

1. **Z.** [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;
2. **Z.** [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;
3. **Z.** [REDAKTUAR] me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;

4. Z. [REDACTED] me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;
5. Z. [REDACTED] me detyrë Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;

- Për mos aplikim të gjobës për subjektet të cilat duke qenë të pajisura me leje mjedisore nuk kanë dërguar në afat të dhënat për gjendjen e mjedisit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 82 pika 2/ç e 2/d si dhe me nenin 83 pika 1/c, ligji nr. 8934, datë 05.09.2002, i ndryshuar me ligjin nr. 9983, datë 08.09.2008.

- Për papërgjegjshmëri dhe nivel të ulët profesionalizmi në plotësimin e aktkontrolleve dhe aktverifikimeve të cilat rezultojnë me gabime si dhe në lënien e detyrave të cilat nuk janë të bazuara në lejen mjedisore përkatëse dhe në ligj.

- Për mosndjekje në vazhdimësi dhe mos kryerjen e kontrolleve periodike në subjekte që rezultojnë pa dokumentacion mjedisor gjë që bën të pamundur të vërtetohet nëse subjekti është pajisur me të si dhe mos kryerjen e rikontrollit të detyrave të lëna gjatë inspektimeve të mëparshme.

- Për trajtimin jo njëloj të subjekteve, për të cilët koha e lënë në dispozicion për tu pajisur me dokumentacion mjedisor nuk është e njëjtë në të gjitha rastet.

2. Për punonjësit si më poshtë:

1. [REDACTED] me detyrë ish Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;
2. [REDACTED] me detyrë ish Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;
3. [REDACTED] me detyrë ish Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;
4. [REDACTED] me detyrë ish Inspektor Mjedisi në Njësinë Inspektuese;

është tejkualuar masa disiplinore e përcaktuar në nenin 37, ligji nr.7691, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar pasi për këta punonjës Ministria e Mjedisit ka marrë masën disiplinore “Largim nga puna”.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Mimoza Lloji, Nefail Xhepexhiu, Neritan Matoshi, Keida Muça, më tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT